



AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE (AKBN)



BILANCI KOMBETAR ENERGJETIK 2011

Tirane 2012

BILANCIN ENERGJETIK 2011

Bilanci energjistik është një dokument që paraqet situatën aktuale dhe rekomandon veprimet dhe ndryshimet që duhet të ndërmerren për të ardhmen në sektorin e energjisë në Republikën e Shqipërisë. Në të janë analizuar dhe përfshirë të gjitha ndryshimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për të rritur sigurinë e furnizimit me burime energjitike, optimizimin e burimeve për mbulimin e nevojave me synim kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të mbare ekonomisë për të ardhmen. Duke mbajtur në konsideratë se ndryshimet në sektorin energjistik nuk ndodhin spontanisht, rishikimi i sistemit energjistik kërkon marrjen e masave shumë të mëdha.

Eksperiencat nga vendet e zhvilluara tregojnë se duhet të vendoset një ekuilibër i drejtë si ndërmjet mekanizmave të tregut dhe ndërhyrjeve të qeverisë ashtu si edhe ndërmjet aspekteve teknike/teknologjike, menaxhimit të energjisë dhe rendesive që duhet t'i kushtohet anës sociale.

Bilanci energjistik, duke qenë në thelb një shprehje e nevojave kombëtare, paraqet informacion që i shërben zhvillimit të qëndrueshëm të mbare ekonomisë kombëtare dhe shërben njëkohsisht edhe mbrojtjen e mjedisit gjatë të gjithë ciklit të shfrytëzimit të burimeve energjitike.

Bilanci energjistik do të jetë pjesë e informacionit të përgjithshëm të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. Gjatë hartimit të një dokumenti të tillë është nivel i besueshmerisë se të dhënat bazë të përdorura për të gjitha analizat, llogaritjet për saktësi dhe përcaktimin e treguesve të përgjithshëm ekonomik për të ardhmen.

Problemet më të rëndësishme me të cilat do të përballë të ardhmen zhvillimi ekonomik i vendit dhe sektori energjetik në veçanti, janë rritja e konsumit të energjisë për banorë dhe mbajtja në të njëjtën kohë e një niveli relativisht më të ulët të intesitetit të energjisë, të cilat kërkojnë nxitjen e një ekonomie efikëse dhe konkurruese. Intesiteti i energjisë në Shqipëri konsiderohet i lartë krahasuar me vendet e rajonit. Për rrjedhojë, sektori i energjisë në Shqipëri do të vazhdojë të përballë me dy sfida të rëndësishme: (i) mbajtjen e këtij intesiteti në nivele mesatare, dhe (ii) rritjen e konsumit të energjisë për banorë (ritjen e komoditetit të jetes).

Ketij qëllimi i shërben paraqitja e bilancit energjetik të vitit 2010 i cili paraqet në mënyrë të sintetizuar, furnizimin e vendit me burime energjitike, të cilat janë të domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit. Gjithashtu ai paraqet lëndët energjetike në transformimin e tyre, duke nxjerrë në mënyrë indirekte problematiken dhe teknologjinë që shërbejnë në përpunimin e tyre, me qëllim efikasitetin e përdorimit të energjisë. Pjesa e konsumit të bilancit ka vlerë, pasi tregon se cilat lëndë energjetike dominojnë tregun, si shpendohen ato, cilat janë problemet e konsumit dhe si duhet të merren masat në përmirësimin e tij.

Domosdoshmëria e Bilancit Energjetik lidhet edhe me problemet dhe sfidat e mëprehta energjetike me të cilat ballafaqohet vendi ynë. Shqipëria vazhdon të paraqet një vend me një konsum energjie për banorë shumë të ulët dhe me një intensitet të lartë energjie si rezultat i teknologjive të vjetra që përdoren në shumë dege të ekonomisë si dhe paisjeve me standarte jo bashkohore që përdoren në sektorin e banesave dhe të shërbimeve. Problemet e alternativave të

furnizimit me burime energjetike kane ndikuar ne nivelet e ulta te aktivitetit ekonomik si dhe ne nivele modeste te komfortit te jeteses.

Ky dokument perfshin nje pasqyre informacioni te gjithë hapsires se zhvillimit te sektorit energjetik, duke filluar nga kërkesa, rezervat, opsionet e furnizimit deri edhe tek sjellja e konsumatoreve. Synimi thelbësor i bilancit është paraqitja e informacionit te sektorit energjetik duke dhene garantimin e nje furnizimi te sigurt me energji per te mbështetur zhvillimin e qendrueshem ekonomik te vendit.

1. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Zhvillimet ekonomike dhe monetare gjatë vitit 2011 u karakterizuan nga rritje pozitive por e ngadaltë ekonomike, politikë fiskale lehtësisht stimuluese, qëndrueshmëri relative e kursit të këmbimit, ulje e primeve të rrezikut dhe presione të dobëta inflacioniste nga ana e kërkesës. Pavarësisht normave pozitive të rritjes ekonomike, ekonomia shqiptare vijon të qëndrojë poshtë potencialit të saj; inflacioni mesatar vjetor është luhatur afër objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe balancat kryesore makroekonomike janë luhatur rreth niveleve të shënuara një vit më parë.

Zhvillimet makroekonomike në vend u ndikuan në masë të konsiderueshme nga ngadalësimi i rritjes ekonomike botërore, nga goditje të kostos që shtrenjtuan faturën e importit dhe nga ecuria e ngadaltë e kërkesës së brendshme. Aktiviteti ekonomik u zgjerua mesatarisht me rreth 2.7% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, i mbështetur kryesisht nga kërkesa e huaj. Të ndikuara edhe nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik jashtë, eksportet kanë vazhduar të rriten por me normë më të ulët. Nga ana tjetër, kërkesa e brendshme, e ndikuar edhe nga sjellja e kujdesshme e agjentit fiskal, ka qenë e plogësht duke dhënë një kontribut minimal në rritjen e kërkesës agregate.

Në aspektin sektorial, struktura e rritjes ekonomike ka qenë e balancuar, e ndikuar si nga kontributi i sektorit prodhues ashtu dhe nga ai i shërbimeve. Të ardhurat buxhetore kanë njohur një rritje të ngadaltë përgjatë vitit 2011, duke reflektuar veprimin e stabilizatorëve automatikë në ekonomi, si edhe efekte të kompozimit të të ardhurave një vit më parë. Zhvillimet në kategorinë e të ardhurave së bashku me angazhimin e autoritetit fiskal për të respektuar kufirin mbi deficitin buxhetor kanë përcaktuar trajektoren rënëse të shpenzimeve përgjatë gjysmës së dytë të vitit.

Deficiti buxhetor në fund të vitit u vlerësua në rreth 3.5% të PBB-së, brenda nivelit të planifikuar në ligjin e buxhetit për vitin 2011. Deficiti i llogarisë korrente si raport ndaj PBB-së shënoi vlerën 12.0%, për nëntëmujorin e parë të vitit 2011. Krahas thellimit të deficitit tregtar, në zgjerimin e deficitit të llogarisë korrente ka ndikuar edhe përkeqësimi i suficitit të llogarisë së shërbimeve.

Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare rezultuan me bilanc pozitiv duke financuar rreth 72.1% të deficitit të llogarisë korrente. Stoku i rezervës valutore është i mjaftueshëm për

mbulimin e 4.4 muaj importesh të mallrave dhe shërbimeve. Kushtet e tregut të punës janë përmirësuar gjatë vitit 2011. Rritja e punësimit është shoqëruar me reduktimin e normës së papunësisë, e cila qëndroi në nivelin 13.3% në tremujorin e tretë të vitit. Në reflektim të këtyre zhvillimeve, rritja e pagës nominale në ekonomi ishte e ulët gjatë nëntëmujorit të parë të këtij viti.

Tabela 1, Disa tregues të ekonomisë në vite

Treguesit	Njësia	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
						Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.90	2.88	2.86	2.83	2.83	2.83	2.83	2.83
Norma e inflacionit (mesatar)	%	3.4	2.3	3.6	3.5	3.0	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	4.7	2.3	3.5	3.1	1.1	1.2	1.2	1.3
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	83.9	95.0	103.9	100.9	102.0	102.5	104.0	104.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	122.8	131.6	137.7	140.5	139.7	140.0	140.0	140.5
Rritja reale e PBB	%	7.5	3.3	3.9	3.0	4.3	5.0	4.9	5.1
PBB	Lek miliardë	1,089.3	1,151.0	1,238.1	1,314.7	1,385.0	1,471.6	1,561.5	1,661.7
PBB	USD miliardë	13.0	12.1	11.9	13.0	13.6	14.4	15.0	16.0
PBB	Euro miliard	8.9	8.7	9.0	9.4	9.9	10.5	11.2	11.8
PBB për banor	Lek mijë	375.2	399.8	433.6	464.3	489.1	519.7	551.4	586.8
PBB për banor	USD	4,472.8	4,208.5	4,171.9	4,601.2	4,795.0	5,070.0	5,302.1	5,642.3
PBB për banor	Euro	3,056.5	3,037.8	3,148.9	3,304.1	3,501.0	3,712.0	3,938.7	4,176.5
PBB për banor	USD-PPP	8,726.3	9,296.8	10,083.3	10,797.1	11,374.1	12,085.6	12,823.8	13,646.5
Norma e papunësisë	%	12.7	13.8	13.5	12.9	12.1	11.4	10.6	9.4
Të ardhurat totale	% të PBB	26.7	26.0	26.2	25.1	25.7	25.7	25.8	25.9
Shpenzimet totale	% të PBB	32.3	33.0	29.3	28.6	28.7	28.6	28.3	28.3
Bilanci i përgjithshëm fiskal	% të PBB	-5.5	-7.0	-3.1	-3.5	-3.0	-3.0	-2.5	-2.5
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-2.7	-3.9	0.3	-0.4	0.6	0.7	1.1	1.1
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	3.1	1.3	2.4	1.9	2.1	1.9	2.0	2.1
Huamarrje totale neto	% të PBB	4.9	4.6	3.1	3.5	3.0	2.9	2.4	2.4
Borxhi Publik Total	% të PBB	54.7	59.3	57.8	58.9	59.6	59.5	59.0	58.1
Borxhi publik i qeverise se pergjithshme	% të PBB	51.3	55.3	54.1	55.2	55.4	55.1	54.3	53.5
Borxhi publik jashte treguesve fiskale	% të PBB	3.4	4.0	3.7	3.7	4.2	4.4	4.7	4.6
Llogaria korente	% të PBB	-15.6	-15.1	-11.7	-12.5	-11.7	-10.9	-8.9	-8.1
Bilanci i mallrave	% të PBB	-27.4	-26.3	-23.2	-22.8	-21.4	-19.8	-17.7	-16.1
Bilanci i shërbimeve	% të PBB	0.8	2.0	2.0	1.4	3.2	3.1	3.5	3.4
Bilanci i Pagesave	% të PBB	2.1	-0.3	2.0	0.7	1.8	1.6	2.7	3.2

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

Rritja ekonomike ka vijuar të mbështetet nga kreditimi i sektorit privat. Situata më e mirë e likuiditetit, përmirësimi i shëndetit të balanceve të bankave dhe prirja rënëse e kostove të huamarrjes, kanë favorizuar rritjen e kredisë dhënë ekonomisë gjatë këtij viti. Megjithatë, kërkesa për kredi vlerësohet të jetë e dobët. Ajo kushtëzohet nga ecuria e ngadaltë e aktivitetit ekonomik, nga pasiguria që shoqëron projeksionet për të ardhmen dhe nga sjellja e kujdesshme e bankave në drejtim të kredidhënies.


Gjatë vitit 2011, tregjet financiare janë karakterizuar nga prirje rënëse e normave të interesit duke reflektuar politikën monetare lehtësuese, situatën e mirë të likuiditetit, stabilizimin e pritjeve për inflacionin dhe primeve të kontrolluara të rrezikut. Nga ana tjetër, kursi i këmbimit

ka ngadalësuar ritmet nënçmuese nga viti i kaluar, i ndikuar nga zhvillimet e ekuilibruara në bilancin e pagesave dhe nga ecuria e tregjeve financiare ndërkombëtare.

1.1.Prodhimi i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës aggregate

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2011 ka vijuar të rritet me norma të përmbajtura, ashtu si dhe gjatë dy viteve të fundit. Prodhimi i brendshëm bruto në terma realë është rritur mesatarisht me rreth 2.7% gjatë nëntëmuorit të parë të vitit, duke u luhatur ndjeshëm nëpër tremujorë. Pas zgjerimit me 4.5% gjatë tremujorit të parë, aktiviteti ekonomik u ngadalësua në rreth 1.0% në tremujorin e dytë, për t'u përmirësuar në 2.6% në tremujorin e tretë. Rritja ekonomike e këtij viti ka vijuar të mbështetet nga kërkesa e huaj, ndonëse në një masë më të vogël si reflektim i ngadalësimit të ekonomisë botërore. Kërkesa e brendshme ka qenë e përmbajtur dhe është formuar më së shumti nga kontributi i sektorit fiskal, gjatë gjashtëmuorit të parë. Të dhënat për ecurinë e shpenzimeve konsumatore dhe të bizneseve gjatë vitit 2011 dëshmojnë për mungesë të dinamizmit të këtyre komponentëve të kërkesës aggregate. Në këndvështrimin e vlerës së shtuar, rritja ekonomike është gjeneruar si nga kontributi i sektorit prodhues, ashtu dhe nga ai i shërbimeve.

Grafiku 1, Ecuria e PBB-së (ndryshime vjetore dhe tremujore, majtas) dhe e treguesit të prirjes ekonomike, normës së shfrytëzimit të kapaciteteve (djathtas).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

1.2.Ecuria e prodhimit sipas sektorëve


Rritja e prodhimit të brendshëm bruto pasqyroi kryesisht ecurinë më të mirë të degëve të transportit, të tregtisë dhe të bujqësisë. Pavarësisht ngadalësimit të aktivitetit të tij ekonomik,

sektori i shërbimeve vijon të mbetet kontribuesi kryesor në rritjen vjetore të PBB-së gjatë nëntëmujorit. Kontributi i tij rezulton i zvogëluar mesatarisht në 1.5 pikë përqindje nga kontributi prej 2.4 pikë përqindje i gjeneruar gjatë të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Në të kundërt, sektori prodhues vlerësohet të ketë shtuar kontributin në 1.2 pikë përqindje në rritjen ekonomike vjetore, krahasuar me 0.1 pikë përqindje të gjeneruar një vit më parë.

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2011, vlera e shtuar në sektorin e industrisë u zgjerua mesatarisht me 5.3% në terma vjetorë, një normë ndjeshëm më e ulët se rritja 15.8% e regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Performanca më e ngadaltë e sektorit të industrisë u ndikua në një masë më të madhe nga përkeqësimi i aktivitetit në degën “Energji elektrike, ujë dhe gaz”.

Më konkretisht, në nëntëmujorin e parë kjo degë gjeneroi një vlerë të shtuar 53.9% më të ulët në terma vjetorë. Zhvillime pozitive shënuan aktivitetet në industrinë nxjerrëse dhe atë përpunuese. Rritjet vjetore të prodhimit dhe të shifrës së afarizmit në vëllim, u pasqyruan në zgjerimin vjetor të vlerës së shtuar në industrinë nxjerrëse (mesatarisht 39.6%) dhe atë përpunuese (mesatarisht 14.5%) në nëntëmujorin e parë të vitit.

Grafiku 2. Kontributet e sektorëve (në pike përqindje) në rritjen vjetore të PBB-së (në %).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Kontributet e sektorëve dhe rritja vjetore e PBB-së janë llogaritur si mesatare të vlerave përkatëse për 4 tremujorët e vitit. Për vitin 2011 në kushtet e disponueshmërisë së të dhënave deri në tremujorin e tretë të tij, kontributet e sektorëve, rritja vjetore e PBB-së dhe vlera e shtuar sipas sektorëve janë llogaritur si mesatare të vlerave për 3 tremujorët e parë të vitit, për të agreguar shifrat për nëntëmujorin e parë 2011.

Tabela 2. Kontributet e degëve (në p. p) në rritjen vjetore të vlerës së shtuar në sektorin e industrisë (në %).

	2008	2009	2010	2011*
Industria nxjerrëse	3.2	-1.6	3.3	4.3
Industria përpunuese	0.8	-1.5	9.7	10.0
Energji elektrike, ujë dhe gaz	3.8	10.2	4.6	-8.9
Industria	7.8	7.0	17.6	5.3

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2011, bilanci i energjisë elektrike në vend shënoi përkeqësime të ndjeshme në disa prej treguesve kryesorë të tij. Këto zhvillime negative janë materializuar në rënien e theksuar të prodhimit vendas, rritjen e ndjeshme të nivelit të importit si dhe reduktimin e eksportit të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2011, prodhimi i energjisë elektrike në vend shënoi rënie me rreth 47.4% në terma vjetorë pas një përmirësimi me rreth 47.5% në vitin e mëparshëm. Situata e pafavorshme hidrike në vend ka bërë që prodhimi vendas të mos arrijë të plotësojë nevojat e brendshme me energji elektrike, duke rënduar ndjeshëm bilancin tregtar të vendit. Importet e energjisë elektrike gjatë vitit 2011 ishin në nivelet më të larta historike, veçanërisht gjatë dy muajve të fundit të vitit. Nga ana tjetër, eksportet rezultuan të ulëta dhe të përqendruara vetëm në muajin janar. Si pasojë e intensifikimit të aktivitetit importues në vend dhe frenimit të eksporteve, bilanci total i shkëmbimit të energjisë elektrike për periudhën e konsideruar rezultoi thellësisht negativ, në rreth 3086.5 GWh, niveli më i ulët historik që prej vitit 2003.

2. INTENSITETI ENERGJETIK DHE KONSUMI I ENERGJISE PER BANORE


Shqipëria paraqitet me një konsum energjie shumë të ulët për banorë. Në një shkallë të madhe kjo zbulon nivelet e ulëta të aktivitetit ekonomik si dhe nivelet modeste të komfortit që krijohen në sektorin e popullatës dhe në ato të shërbimeve. Kështu, një nga çështjet më të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë shqiptare dhe sektorit të saj të energjisë është, se si mund të barazohet presioni i vazhdueshëm për të rritur konsumin e energjisë për banorë me nevojën, si dhe padëshim të njejtë, për të reduktuar intensitetin e lartë të energjisë, për të pasur një ekonomi efikente e cila me tej të konkurojë si në tregun e brendshëm me mallrat e importit ashtu edhe në tregun e jashtëm, për të bërë të mundur ekzistencën e tregjeve të eksportit për kategori të caktuara mallrash dhe produktesh.

Konsumi energjetik për banorë është një tregues tjetër që shpreh mirqenien, mënyrën e jetesës por nga ana tjetër dhe sjelljen apo qëndrimin e konsumatoreve kundrejt konsumit të burimeve energjetike.

Treguesi i konsumit të energjise për frymë të popullsisë për vitin 2011 rezultoi 0.617 toe/banor, ndërsa për vitin 2010 rezultoi në nivelin e 0.589 toe/banor. Për vitin 2009 konsumi energjetik për banor është vlerësuar në vlerën e 0.588 toe/banor.

Intensiteti energjetik është një tregues sintetik shumë i rendesishëm, që tregon nivelin e zhvillimit të sektorit energjetik, sidomos në drejtim të eficiencës së energjise. Ai shpreh raportin e konsumit të burimeve primare energjetike në një vit të caktuar me PBB-në të prodhuar po në atë vit. Historikisht, intensiteti i energjise në Shqipëri ka qenë shumë i lartë. Kjo do të thotë, se prodhimi makro ekonomik, i raportuar normalisht nga PBB-ja ka qenë i ulët, krahasuar me konsumin e përgjithshëm të energjise. Arsyeja janë të njëjta si dhe për vendet e tjera të Europës Qendrore dhe Lindore: industria shqiptare ka qenë e orientuar drejt industrive intensive me konsum të lartë të energjise si minierat dhe metalurgjia, ku çmimet e ulëta të energjise kanë mbizotëruar gjatë gjithë kohës.

Intensiteti energjetik për vitin 2011 rezultoi të jetë në nivelin 0.277 toe/000Euro. Ky intensitet rezultoi me një përmirësim të tij që e ka baze në konsumin e burimeve energjetike përkundërt një PBB-je me të lartë se ajo e vitit 2010. (PBB-ja ka qenë 9.4 miliard Euro në vitin 2011). Intensiteti energjetik për vitin 2010 ka qenë në nivelin e 0.285 toe/000Euro. Zvogëlimi i Intensitetit Energjetik lidhet me përdorimin efektiv të energjise në shkallë vendi.



Grafiku 3: Intensiteti Energjetik dhe Konsumi / banor. Vitet 2007-2011

3. NDERTIMI I BILANCIT DHE SIGURIMI I INFORMACIONEVE

Bilanci i vitit 2011 është ndërtuar në metodikën e vlerësimit si nga lart-poshtë dhe nga poshtë lartë për të duke patur një vlerë mosperputhjeje 11% që do të thotë një shfër të pranueshëm për vendet në zhvillim si është Shqipëria. Bilancet ndjek një ecure si të viteve 2000-2011 kjo bazuar

ne eksperiencat dhe rekomandimet e institucioneve nderkombetare me te cilat bashkepunohet vazhdimisht.

Analiza e verifikimit kryhet per te gjetur shifrat sa me te sakta te konsumit final te energjise dhe pse raportimet per furnizimin me lende energjetike, kryesisht produkte naftë dhe dru zjarri nuk i pergjigjen konsumit real te konsumatoreve. Kjo diference ndodh, per drute e zjarrit nga mungesa e statistikave te organeve pergjegjese qe e menaxhojne kete lende energjetike, ndersa produktet e naftes kryesisht karburante nga lëvizja e lire kufitare dhe informaliteti.

Theksojme se metodologjia kontrollit te bilancit nga poshte-lart perdoret jo vetem ne vendet e rajonit tone por edhe ne vendet e zhvilluara per te kontrolluar sasite e flukseve te lëvizjes se produkteve te naftes. Kjo metodologji llogaritje eshte mjaft e rendesishme per vendin tone duke patur ne konsiderate hapjen e kufijve dhe mundesine e futjes te lendeve hidrokarbureve (karburante per automjete) nga vendet fqinje si pasoje e rritjes se fluksit te automjeteve qe hyjne dhe dalin ne pikat kufitare.

Hartimi i Bilancit Energjetik, eshte mbështetur ne te dhenat e mbledhura nga institucionet shteterore dhe kompanite e ndryshme, te cilat operojne ne fushen e energjise ne Shqiperi.

Institucionet dhe informacionet e siguruar nga to , jane si me poshte :

Informacionet mbi te dhenat makroekonomike dhe popullsia jane siguruar nga :
Keshilli i Ministrave ; Ministria e Financave

Te dhenat mbi energjine elektrike jane siguruar nga:

Enti Rregullator i Energjise (ERE)

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a)

Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST sh.a)

Operatorit i Sistemit te Shperndarjes (OSSH sh.a)

Te dhenat per hidrokarburet jane siguruar nga:

Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjetikes (METE)

Raporti vjetor i shoqerise Albpetrol sh.a Viti 2009;

Raporti vjetor i shoqerise ARMO sh.a Viti 2010;

Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave;

Te dhenat per drute e zjarrit, jane siguruar nga:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerve;
Investigimi nga AKBN-ja

Te dhena per sektorin e transportit, jane siguruar nga:

Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Investigimi nga AKBN-ja

Te dhenat per sektorin e bujqesise, jane siguruar nga:

Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe e Mbrotjes se Konsumatorit
Investigimi nga AKBN-ja

Te dhenat per sektorin e industrise, jane siguruar nga:

Qendra e Kombetare e Regjistrimit

4. FORMATI I BILANCIT ENERGJETIK

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 202, date 11.04.2007, “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 547, date 9.8.2006, “Per krijimin e Agjencise Kombetare te Burimeve Natyrore”, Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore, ka detyrim te pergatise Bilancin Energjetik ne perputhje me formatin EUROSTAT/IAE.

Nga Instituti i Statistikave i Shqiperise (INSTAT), Ministrite, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH), Enti Rregullator i Energjise (ERE) etj, sigurohen te dhena ne lidhje me ekonomine e Shqiperise, te dhena makroekonomike, cmimet, konsumi i elektricitetit, te dhena mbi popullsine, ndertesat, etj.

Vlen per t’u shenuar fakti, se ka te dhena mbi Sektorin e Banesave, ne lidhje me ndertesat bazuar ne kategorite e ndryshme te tyre, si dhe disa te dhena te dobishme mbi sektorin e ndertimit publik

Gjithashtu ka te dhenat per sektorin e transportit, lidhur me numrin e automjeteve, kamioneve, autobuzeve dhe furgonave dhe te dhenat te tjera. Bazuar ne Censusin, te publikuar nga INSTAT, jane siguruar te dhena mbi numrin e banesave, mesataren e personave per banese, te ardhurat e tyre, punesimin ne sektoret publik dhe privat, bizneset ne te gjithe vendin (ndermarrjet), etj.

Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore dhe Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes (METE) kane se bashku detyren e mbledhjes dhe perpunimit te te dhenave, formulimit te pasqyrave dhe treguesve te energjise, analizimit dhe shperndarjes se informacionit.

Per hartimin e Bilancit Energjetik , te dhenat e mbledhura perpunohen dhe analizohen , duke i pershtatur me kerkesat e formatit te Eurostatit per Bilancin Energjetik.

Duhet theksuar se Bilanci i Energjiise percaktohet ne perputhje me metodologjine EUROSTAT, vetem ne pasqyren agregate dhe jo ashtu si ajo duhet te jete, ne detaje,kjo per aresye se per te dhenat e konsumit te energjiise ne deget e ndryshme te energjiise, eshte ende e nevojshme te nxirren te dhena me te detajuara .

Veshtiresi ndeshen edhe ne procesin e vleresimit te humbjeve pergjate proceseve te transformimit nga burimet primare te energjiise ne burime sekondare, sic jane produktet e naftes, energjia e marre nga djegia e qymyreve per qellime energjetike, energjia elektrike e perftuar nga TEC-et.

Ashtu sic eshte permendur edhe me lart, ende nuk ka te dhena te detajuara dhe te mjaftueshme per sa i perket kerkeses; si rrjedhim eshte e nevojshme te permiresohen statistikat mbi energjiine, si per anen e furnizimit, ashtu edhe per ate te kerkeses, kjo edhe ne kuader te Komunitetit te Energjiise, ku Shqiperia dhe te gjitha vendet e rajonit brenda vitit 2015 do te kene per detyrim te hartojne bilancet energjetike plotesisht sipas kerkesave te EUROSTAT-it .Prandaj kerkohet, qe Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore te mbeshtet me nje kuader me te plote ligjor , per te mundesuar sigurimin e te gjitha te dhenave me te nevojshme, te kerkuara prej saj.

5. STRUKTURA E BURIMEVE ENERGJETIKE NE BILANCIN ENERGJETIK

5.1 Burimet dhe konsumi energjetik

Nga një vështrim i përgjithshëm i furnizimit gjithsej me burime energjetike primare, nga viti 2003 e deri në ditët e sotme, vërejmë se furnizimi për të gjithë sektorët ka pësuar një rritje nga viti në vit. Per t'i paraprire rritjes se kerkeses per konsum te lendeve energjetike jane zhvilluar mjaft projekte ne fushen e energjiise, si per rritjen e prodhimit te burimeve primare ne vend ashtu dhe per krijimin e nje infrastrukture energjetike interkonjeksioni ne menyre qe vendi yne te integrohet ne rrjetat Europiane te energjiise per te marre pjese ne tregun kompetitiv te energjiise elektrike dhe gazit natyror.

Burimet energjetike qe dominojne dhe kane mbajtur peshen kryesore ne Bilancin Energjetik jane: nafta dhe nen produktet e saj, hidroenergjia, drute e zjarrit, qymyri, gazi natyror dhe pak produkte dytesore te cilat vijne si rrjedhoje e shfrytezimit te energjiise diellore dhe nxehtesise se perftuar nga proceset termike.

Tabela 3. Burimet Energjetike 2011

Burimet Energjetike	%	ktoe
Qymyri	3.31%	71.41
Gazi	0.69%	15.0
Nafta dhe produktet	57.13%	1231.74
Drute e zjarrit	9.65%	208.00
En.djellore	0.54%	11.70
Hydro	28.67%	618.16

Per vitin 2011, Totali i Produkteve Primare Energjetike (TPPE) ka rezultuar ne 2161,79 Ktoe, me nje rritje 56.24 ktoe krahasuar me vitin 2010 si pasoje e ritmit vjetor te konsumit. Në furnizimin sipas burimeve, për vitin 2011 vlen të përmendet që hidrokarburet kanë kontribuar me 1231.74 ktoe, ose 57.13% përkundrejt totalit, energjia elektrike me 618.16 ktoe, ose 28.67%, drutë e zjarrit me 208 ktoe, ose 9.65%, vlen te permendim rritjen e perdorimit te qymyrit me 3.31 % ose 71.41 ktoe dhe pjesa tjetër përbëhet nga burime të tilla si qymyri, gazi natyror dhe energjia e përftuar nga panelet diellore.




Figura.4: Burimeve Primare Energjetike per vitin 2011. [%]

Pavarësisht se situata e furnizimit me produkte primare energjetike vjen gjithmonë në rritje, tregu i vendit tonë kërkon përmirësime në sigurinë e furnizimit me energji. Në figuren 5 jepen garifikisht kontributi i produkteve primare.




Figura 5: Ecuria ne vite e burimeve energjetike 2005-2011 [ktoe]

Vlen te permendim qe per vitin 2011 prodhimi i naftes brut ka nje maksimum krahasuar me vitet e tjera duke aritur vleren 894.53 ktoe. Importet per vitin 2011 kapin vleren 67 %, ku kontributin kryesor e kane lendet energjetike me baze hidrokarbure dhe energjia elektrike kjo e fundit sipasoj e prodhimit te ulet te hidrocentraleve krahasuar me vitin 2010. Eksportet kapin vleren 36 %. Ne figuren 3 eshte paraqitur ecuria ne vite e Totalit te Produkteve Primare Energjetike (2005-2011) e shprehur ne ktoe.

5.2. Veteplotesimi i nevojave me burime energjetike

Ne krahasim me vitin 2011, vihet re nje ulje e lehte e veteplotesimit te nevojave me burime energjetike krahasuar me vitin 2010, kjo si pasoje e prodhimit te ulet te energjise elektrike si dhe exportit te larte te naftes se brut. Raporti i plotesimit te nevojave energjetike me produkte vendi per vitin 2011 ishte 30.9% dhe pati nje ulje krahasuar me vitin 2010 gati 7 % e cila ka ardhur si rrjedhoje e rritjes se eksportit te naftes brut, nga 501 ktoe per vitin 2010 ne 697 ktoe per vitin 2011, ndersa prodhimi i energjia elektrike u ul krahasuar me vitin 2010 nga 665.92 ktoe ne 357.59 ktoe ne vitin 2011. Prodhimin vendas te hidrokarbureve ka nje rritje nga 743.9 Ktoe ne vitin 2010 ne 894.53 ktoe ne vitin 2011.




Figura 6: Veteplothesimi me burime energjetike 2011 [%]

6. ANALIZA E SIGURIMIT TE BURIMEVE ENERGETIKE

6.1 Furnizimi me nafte dhe nenproduktet e naftes

Furnizimi i ekonomisë me nënprodukte nafte dhe gazi realizohet nga importi dhe prodhimi vendas. Megjithatë prodhimi vendas i nënprodukteve të naftës dhe gazit plotëson rreth 12.5 % të nevojave të ekonomisë, kjo për shkak të mospërpunimit të gjithë sasisë së naftës bruto të prodhuar në vend. Produktet e naftës të përpunuara në vend luajnë rol në tregun e vendit për konsumatorët industrial dhe të shërbimeve. (Grafiku 6). Niveli i prodhimit të naftës bruto në total (Albpetrol, Bankers Petroleum Albania Ltd dhe Stream Oil & Gas) për vitin 2011 arriti në 894.530 Ktoe i cili është niveli më i lartë në 15 vitet e fundit.

Duhet theksuar se, për një shfrytëzim më të mirë të vendburimeve tona të naftës, për rritjen e koeficientit të naftënxjerrjes nëpërmjet përdorimit të teknologjive të ndryshme si dhe për kërkimin dhe zbulimin e vendburimeve të reja, janë nënshkruar dhe miratuar marrëveshje hidrokarbure me disa kompani të huaja të tilla si Bankers Petroleum Albania Ltd, Steam Oil & Gas, Sharewood International Ltd dhe IEC Visoka Inc. në vendburimet ekzistuese dhe Island International Exploration BV, Medoil dhe DWM Petroleum AG si dhe Petromanas Albania GmbH, Island International Ltd; Capricorn, Bankers Petroleum Albania Ltd. në blloqet e reja të kërkimit.


Spektori i rafinimit të naftës bruto përballlet me vështirësi, si pasojë e teknologjisë së vjetër, si dhe mungesës së një sistemi modern për operacionet e punës dhe mirëmbajtjes së sistemit të kontrollit. Ai ka pasur probleme serioze në kontrollin e ndotjeve mjedisore, të cilat dora dorës, për shkak të investimeve të realizuar në këtë sektor, ka pësuar përmirësime. Pas privatizimit të

ARMO Sh.A të 85% të aksioneve, ka përpjekje serioze në drejtim të cilësisë të prodhimit të nënprodukteve, duke përmendur këtu Gazoilin, ndërkohë, që duhet të vazhdohet në drejtim të rritjes së cilësisë së nënprodukteve të tjera, për të qënë konkurruese në tregun vendas dhe atë rajonal, por edhe për të mundësuar rritjen e kapaciteteve përpunuese të naftës bruto në vend, duke realizuar kështu një rritje të vlerës së këtij burimi natyror strategjik me të cilën është e pasur nëntoka Shqiptare.

Sektori i rafinerisë është i privatizuar dhe përfaqësohet nga shoqëria ARMO sh.a ku shteti ka 15 % të aksioneve. Në zhvillimet strategjike të sektorit të energjisë opsioni për ndërtimin e një rafinerie të re është marrë në konsideratë.

Infrastruktura bregdetare e import-eksportit dhe depozitimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve është modernizuar dhe operohet në dy terminale bregdetare, atë të (Porti Vlora-1) Vlorës dhe të Porto-Romanos, Durrës, (Porti “Porto Romano”), të cilat kanë kapacitete të konsiderueshme përpunimi dhe depozitimi, si dhe janë ndërtuar në përputhje me standartet e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Shpërndarja gjeografike e impianteve, magazinave dhe stacioneve të shitjes të shoqërive të tregtimit me shumicë dhe shoqërive të tregtimit me pakicë, përfshin të gjithë territorin e Shqipërisë. Ato garantojnë një furnizim normal të konsumatorëve në mbarë vendin. Rezerva e sigurisë ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Për vitin 2007, ajo ka qënë 41 684 ton dhe për vitin 2008 ka qënë në nivelin e 102 985 ton dhe në vitin 2010 ajo është 187 886 ton. Megjithatë, në kuptimin e menaxhimit të rezervës së sigurisë ka nevojë për një rishikim, kjo në përputhje edhe me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe për këtë qëllim gjatë vitit 2012, është parashikuar të bëhet një studim i thelluar për rezervën e sigurisë.



Grafiku. 7: Ecuria e prodhimit vendas të naftës bruto sipas vendburimeve dhe e konsumit [ktoe]

Burimi: AKBN

Importi i produkteve të naftës dhe i naftës bruto për vitin 2011 arrin vlerën 1105.2 ktoe duke patur një rritje me 24.77 ktoe krahasuar me vitin 2010. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes të

parkut te automjeteve. Eksporti i naftes dhe i produkteve te saj per vitin 2011 arriti 696.7 ktone duke pesuar nje rritje 28 % ktone krahasuar me vitin 2010. Rritja ne vitin 2011 ka ardhur si pasoje e shtimit te sasise se eksportit te naftes brut nga kompania Bankers dhe sasite e larta te produkteve te eksportuara nga kompania ARMO te tilla si benzin verxhine, koks, solar dhe bitum.

Nxjerrja e gazit

Aktualisht, vendi ynë ka një prodhim minimal gazi natyror, rreth 15 Milion Nm³, sasi gati e papërfillshme dhe që shërben vetëm për furnizimin e rafinerive dhe proceseve teknologjike të industrisë së naftës. Pavarësisht, angazhimet dhe nxitjen e investitorëve të huaj, nga të gjitha strukturat e shteti shqiptar, vendi ynë nuk është lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit. Është e kuptueshme, se lidhja e Shqipërisë me rrjetin e gazit do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e situatës energjetike në vend, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në raportet e përdorimit të energjive, ku deri më sot ngarkesa kryesore i takon nënprodukteve të naftës dhe energjisë elektrike.

Gazi i lëngët i naftës (GLN) në vendin tonë, ka rritur në mënyrë të ndjeshme prezencën dhe po luan një rol gjithmonë e më të madh në tregun vendas, si burimi energjetik alternativ më i mundshëm, për të zëvendësuar energjinë elektrike në sektorin e banesave dhe shërbimeve, duke u konsumuar kryesisht për ngrohje dhe gatim, duke arritur në total për vitin 2011 një konsum prej 101 ktone. Një përdorim gjithmonë e më të gjerë kjo lëndë energjetike po gjen në industrinë ushqimore dhe atë të ndërtimit.

Duke patur parasysh GLN-në si alternative energjetike, që zëvendëson me shpejtësi konsumin e energjisë elektrike, politika e Qeverisë është drejtuar në zhvillimin e kapaciteteve depozituese në volume të ritura, për të ulur koston e transportit. Në mbështetje dhe në zbatim të këtyre objektivave strategjike, si rezultat i investimeve të realizuara gjatë viti 2009, u futën në shfrytëzim terminalët bregdetarë të naftës në Gjirin e Vlorës (Porti Vlorë-1 dhe terminali i depozitave nga shoqëria koncesionare “La Petrolifera Italo Albaneze”sh.a.), si dhe në zonën e Porto-Romanos, Durrës, (Porti “Porto Romano”nga shoqëria koncesionare “Romano Port”sh.a.

6.2 Sektori i rafinerise

Gjate vitit 2011 shoqëria e perpunimit dhe marketingut te naftes ARMO bleu nafte brut nga Shoqëria Albpetrol, kompania Bankers dhe nga kompania Steam Petroleum 241.52 ktone, dhe importoi 55.2 ktone dhe ne total perpunimi i naftes brut ne rafinerite tona ishte 296.72 ktone.

Humbjet teknologjike te rafinerive kane qene rreth 3.4 %. Viti 2011 ka nje vit narmal per shfrytezimit te naftes brut ne rafinerine e Ballshit dhe te Fierit .

Shoqeria ARMO sh.a e privatizuar ne vitin 2008 (85% e aksioneve), gjate vitit 2011 e ne vazhdim, do te mundesoje nje permiresim te ndjeshem ne sektorin e rafinimit dhe arritjen e standarteve nderkombetare ne cilesine e nenprodukteve.

Duke mbajtur ne konsiderate Totalin e Produkteve Primare Energjetike (TPPE), humbjet ne procesin e transformimit per hidrokarburet, rezultojne te jene ne nivelin e 10.6% te TPPE-se.

6.3 Cmimet e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj

Nenproduktet e naftes dhe te gazit ne tregun shqiptar jane te liberalizuara dhe ndjekin ne menyre rigoroze ecurine e cmimeve te ketyre nenprodukteve ne bursat nderkombetare duke shtuar atyre taksat dhe tatimet sipas niveleve te pershkruara, per cdo produkt, koston e transportit si dhe normen mesatare te fitimit (rreth 10%). Per vitin 2011 ne çmimin e produkteve te naftes u shtua dhe taksa e mjedisit e cola eshte 5 dhe 8 lek per liter.

Per sa i perket cmimit te naftes bruto te prodhuar ne vend, pas vitit 2008, me privatizimin e shoqerise se rafinimit ARMO sh.a., ky cmim eshte i lidhur ne menyre te drejtperdrejte me kuotimin e ketij produkti ne bursen BRENT, pavaresisht nga kostoja e prodhimit te tij nga shoqerite e kerkim prodhimit qe operojne ne territorin e Republikes se Shqiperise. Mbi prodhimin e shitur te naftes bruto aplikohet nje takse prej 10%, e quajtur “Rente Minerare”, sipas dispozitave te Ligjit Nr. 9975, date 28.7.2008 “Per taksat kombetare”, i ndryshuar.

7. ENERGJIA ELEKTRIKE

Prodhimi i energjise elektrike ne vendin tone eshte i bazuar ne prodhimin e saj nga burimet hidrike (me shume se 98%), prandaj dhe besueshmëria e sistemit tone elektroenergjetik eshte shume e varur nga kushtet hidrike. Fuqia e instaluar e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar eshte rreth 1531 MW dhe prodhimi i energjise elektrike nga burimet e vendit, duke qene se eshte nga burimet hidrike, ka natyre propabilitare, qe leviz nga rreth 3 miliard kWh/vit deri ne 7,7 miliard kWh/vit, ne varësi te kushteve hidrike (rreth 7,7 miliarde kWh ne vitin 2010). Prodhimi mesatar vjetor eshte rreth 4.2 miliard kWh. Duke patur ne konsiderate, qe kërkesa per energji elektrike ne vendin tone aktualisht eshte 7.342 TWh/vit, dhe prodhimi vendas rreth 4.2 TWh/vit, pra eshte i pamjaftueshem, ben te detyrueshem qe aktualisht, mbulimi i nevojave duhet te perballohet nepermjet importit te energjise elektrike.

Nga ana tjetër, duhet te vemë ne dukje, qe kapacitetet importuese te vendit tone jane te limituara. Kjo vjen si pasojë e kapaciteteve te limituara, qe kanë linjat tona te interkonjeksionit me vendet fqinjë, por edhe te linjave te interkonjeksionit te vendeve te rajonit, pasi vendi yne eshte pike fundore ne rrjetin rajonal te energjise elektrike.

Duhet theksuar gjithashtu, se importi i energjisë elektrike është vështirësuar edhe për shkak të rritjes së deficitit të energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit, ku numri më i madh i vendeve, përveç Bullgarisë, Rumanisë dhe Bosnje Hercegovinës, janë importues neto të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2011 prodhimi i përgjithshëm neto i energjisë elektrike nga shoqëritë publike të gjenerimit ka qenë 4 021 245 Milion kWh, kurse prodhimi total, që merr parasysh edhe prodhimin nga sektori privat i gjenerimit prej 136 831 Milion kWh, arriti në 4 158 831 Milion kWh (4.158 TWh).




Figura 8. (Burimi KESH, OST)

Viti 2011, nga pikpamja hidrologjike, vlerësohet si një vit me prurje me shkallë të ulët sigurie, gjë që ka ndikuar jo pozitivisht në prodhimin e energjisë elektrike në vend, duke shënuar një nga vitet me prodhimin më të ulët në historikun e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri.

Në tabelën 1 janë paraqitur treguesit kryesorë të energjisë elektrike nga viti 2002 dhe deri në vitin 2011.

Tabela 3 Treguesit kryesorë të energjisë elektrike

Emertimi	Viti									
	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Prodhim (GWh)	3,204	4,974	5,467	5,409	5,516	2,933	3,770	5201	7743	4185
Importi (GWh)	2,072	937	567	365	633	2,828	2,417	1884	0	3262
Furnizimi (GWh)	5,430	5,900	5,945	5,933	6,121	5,750	6,300	6592	6773	6872
Sasia vjetore e Ujit (Miljard,m3)	4.44	5.8	7.81	6.74	6.52	4.11	4.12	6.00	10.85	5.08
Konsumi specifik (m3/kWh)	1.38	1.17	1.43	1.25	1.18	1.40	1.04	1.19	1.20	1.20

Rritja mesatare vjetore e kërkesës për energji, në vlefte absolute, gjatë kësaj periudhe rezulton me 183 GWh/Vit. Në periudhën përpara vitit 2008, për shkak të ndërprerjeve të programuara, të detyruara, të energjisë ky tregues nuk është real. Duke ju referuar viteve 2009, 2010 dhe 2011, konstatohet, se rritja e kërkesës për energji në vitin 2010 rezulton 378 GWh më shumë në vlefte absolute se në vitin 2009, ose me 6% më shumë, ndërsa në vitin 2011 me 372 GWh ose me 5% më shumë se viti 2010.

TEC Vlora ishte parashikuar të vihej në punë gjatë vitit 2011, por për shkak të problemeve teknike të konstatuara gjatë testimeve u vonua futja plotësisht në punë me kapacitetet të plote të këtij burimi. Gjatë kësaj periudhe TEC-i prodhoi 59.611 milion kWh energji elektrike.

Sikurse dihet, ky TEC është i projektuar dhe konstruktuar që të punojë dhe me gaz natyror, por aktualisht ka përdorur si lende djegëse naftë diesel, mbasi ende nuk është realizuar furnizimi i Shqipërisë me gaz natyror, për pasojë kostua e prodhimit të energjisë elektrike prej tij është shumë më e lartë se ajo e HEC-eve egzistues, mbasi çmimi i naftës në tregjet ndërkombëtare, sikurse dihet, është tepër i lartë.

TEC-i i Vlores ka të instaluar dy turbina nga të cilat njëra turbine me gas dhe tjetra klasike me avull me presion të lartë dhe me prodhimtari, përkatesisht 70% dhe 30% të kapacitetit të përgjithshëm nga secili agregat.

HEC-et private. Aktualisht janë në prodhim 58 hidrocentrale nga 26 shoqëri private dhe koncensionare, me fuqi të përgjithshme të instaluar prej 43.12 MW nga të cilat 17.25 MW janë shtuar gjatë vitit 2011. Prodhimi i përgjithshëm për vitin 2011 nga gjeneruesit e private është 136.8 GWh ose 2.0 % e prodhimit të përgjithshëm të vitit 2011. Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike nga HEC-et deri 15 MW nga 159.01 GWh që ishte në vitin 2010 gjatë vitit 2011 arriti në 136.8 GWh, ose pati një rënie prej 14% për shkak të situatës së pafavorshme hidrore.

Importi i energjisë elektrike.

Në zbatim të kërkesave të Modelit Shqiptar të Tregut, importet e energjisë elektrike për nevojat publike në vendin tonë, kryhen nga dy furnizues publik, ai me shumicë (FPSH) në përberje të

KESH-it dhe nga OSSH (CEZ Shperndarje). Ndersa FPSH importon energji per te plotesuar nevojat e klienteve tarife, OSSH importon energji per te mbuluar humbjet e energjise elektrike ne sektorin e shperndarjeve.

Ndryshe nga viti 2010 ku per here te pare qe mbas vitit 1998, ne bilancin e pergjithshem import-eksport, eksportet tejkaluan importet dhe vendi yne rezultoi si vend eksportues neto i energjise elektrike, viti 2011 perseri sjell kthimin e vendit ne importues neto.

Ne grafikun e figures 9. eshte paraqitur bilanci import-eksport i energjise elektrike per periudhen 1985 – 2011. Sikurse vihet re deri ne vitin 1998, (me perjashtim vetem te vitit 1990) vendi yne ka qene nje vend eksportues neto i energjise elektrike.




Figura 9 Balanca Export-Import i Energjise Elektrike (GWh)

7.1 Humbjet e energjise elektrike.

Nese ne prodhimin publik te energjise elektrike efienca e kesaj veprimtarie vjen duke u rritur nga viti ne vit, nuk mund te themi te njejtën gje per ritmet me te cilat po permiresohet efienca e konsumit te energjise elektrike.

Faktoret qe determinojne uljen e efieneses se konsumit te energjise elektrike jane:

- Niveli i larte i humbjeve te energjise elektrike ne shperndarje. Humbjet totale dhe humbjet jo teknike dhe teknike ne vecanti, kane nivele te papranueshme, cka reflektohet ne nivelin e ulet te faturimeve te energjise elektrike ndaj konsumit te pergjithshem.
- Niveli i ulet i arketimeve te energjise elektrike te faturuar.




Figura 10 Ecuria e Humbjeve ne sistemin e shperndarjes

Humbjet e pergjitheshme ne shperndarje gjate vitit 2011, duke marre ne konsiderate edhe konstatimet e ERE-s mbi demin ekonomik dhe energjine e pafaturuar perbejne 37.58% te energjise se pergjitheshme te injektuar ne sistemin e shperndarjes,

Niveli i arketimeve i raportuar nga CEZ Shperndarje per vitin 2011 eshte 70.69% te energjise elektrike te faturuar. Kjo shifer perfshin edhe arketimet e prapambetura te periudhes 2006-2010 ne vleften 6.9 miliard leke. Niveli i arketimit te vitit 2011 per faturat korente, raportohet nga CEZ shperndarje ne 59%.

Koeficienti vjetor i efektivitetit per sistemin e shperndarjes (i cili merr parasysh nivelin vjetor te humbjeve dhe te arketimeve) rezulton me 49.63%. Verehet qarte se niveli i eficiences ne shperndarje eshte ulur me 4.11% ne krahasim me vitin 2010.

Ne sistemin e transmetimit humbjet e energjise elektrike jane ne vleften 172.9 GWh dhe perbejne 2.3% te energjise se injektuar ne sistemin e transmetimit.

Humbjet totale faktike per vitin 2011, te cilat marrin parasysh humbjet ne rrjetin e shperndarje me 2440 GWh dhe humbjet ne rrjetin e transmetimit me 172.9 GWh jane gjithesej 2,613 GWh ose 35.6% e gjithe energjise se injektuar ne sistemin elektroenergjetik te vendit.

7.2 Tarifat e Energjise Elektrike

ERE ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003, "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar, ka hartuar dhe miratuar metodollogjite per llogaritjen e tarifave te aktiviteteteve te rregulluara ne sektorin e energjise elektrike.

ERE per te garantuar nje proces transparent dhe te drejte te percaktimit te tarifave zbatoi me korrektesi Vendimin Nr.21 date 18.03.2009 i Bordit te Komisionerve te ERE-s i ndryshuar me Vendimin Nr. 107 date 17.10.2011 për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s” i cili percakton etapat dhe procedurat permes te cilave duhet te kryhet procesi i aplikimit, shqyrtimit dhe miratimit te tarifave te energjise elektrike.

Duke patur parasysh parimet e percaktuara ne aktet nenligjore te mesiperme dhe duke qene se tarifat e sherbimeve te energjise elektrike jane te transferueshme tek cmimet e shitjes me pakice per klientet tarifore/fundore, kerkesat e paraqitura per rishikimin e ketyre tarifave nga shoqerite, u shqyrtuan njekohesisht nga ana e ERE-s.

Me 1 Shtator 2011, KESH sha., i licensuar per prodhimin e energjise elektrike, paraqiti ne Entin Rregullator te Energjise aplikimin per rishikimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike per periudhen e trete rregullatore 2012-2014.

Tarifatper vitet 2012, 2013 dhe 2014 te propozuara nga ana e KESH/Gen per prodhimin e energjise elektrike ishin respektivisht 1.10 leke /kWh, 0.99 leke /kWh dhe 1.04 leke /kWh, pra me nje rritje mesatare vjetore prej 65 % nga tarifa e meparshme e vitit 2011 prej 0.63 leke/kWh. Ne perfundim te analizave dhe metodologjise se perdorur cmimi mesatar me pakice per konsumatorët tarifore rezultoi 9.53 leke/kWh, qe eshte i njejte me cmimin mesatar te miratuar nga ERE per vitin 2011. Ky cmim mesatar shperndahet tek grupet e konsumatoreve tarifore sipas tabelës 4

Tarifat e shërbimeve dhe të shitjes me pakice të energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014

Niveli i Tensionit	Kategoritë e Konsumatoreve	Viti 2012-2014	
		Cmimi (leke/kWh)	Cmimi i energjisë në pik (leke/kWh)
TENSIONI I MESEM	Kliente të furnizuar në 35 kV		
	Industri	8.50	9.78
	Tregeti & shërbime	8.50	9.78
	Bujqësi	8.50	9.78
	Te tjere	8.50	9.78
	Kliente të furnizuar në 20/10/6 kV		
	Industri	9.10	10.47
	Tregeti & shërbime	10.00	11.50
	Furra buke, prodhim mielli	7.10	8.17
	Bujqësi	8.70	10.01
	Te tjere	9.70	11.16
	Buxhetore	11.50	13.23
	Kliente të furnizuar në TU		
	Industri	10.50	12.08
TENSION I ULET	Tregeti & shërbime	12.20	14.03
	Furra buke, prodhim mielli	7.60	8.74
	Bujqësi	10.50	12.08
	Te tjere	12.00	13.80
	Buxhetore	14.00	16.10
	Familjare		
	Blloku I për deri në 300 kWh	7.70	
	Blloku I dytë mbi 300 kWh	13.50	
	Tarifa fikse e shërbimit për leximin "zero" (leke/muaj)	200	
	Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (shkallë, pompe, ashensor, etj (leke/kWh)	8.00	
	* Cmimi i energjisë reaktive do të jetë 15% e cmimit të energjisë aktive		

Tabela 4 Cmimi mesatar i energjisë elektrike

7.3. Humbjet nga Transformimi dhe eficientia e sistemit energjetik shqiptar

Në total, humbjet nga procesi i transformimit të burimeve energjetike primare, vlerësohen në vlerat 12.7 ktoe ose 0.66% të TPP-se, dhe respektivisht humbjet në procesin e transformimit për burimin energjetik të naftës kanë qenë në vlerat 10 ktoe dhe për energjinë elektrike 2.7 ktoe.

8. QYMYRI

Konsumi i qymyrit për vitin 2011 ka patur një rritje për shkak të kërkesës së lartë të konsumatorit industrial me 69.8 ktoe dhe me një prodhim vendas të ulet deri në 1.6 Ktoe. Vlen të theksojmë se deri në vitin 2008 në shqiperi konsumi i qymyrit ka qenë i ulet, me pas shumë konsumatore industrial filluan të importojnë qymyr nisur nga levedishmeria ekonomike si dhe kërkesat e ulta të vendit tona në lidhje me problemet ambientale të tij.

Aktualisht, kapacitetet e minierave te qymyrit jane ne minimumin e tyre, duke prodhuar rreth 7000-9000 ton nga 2 milion ton qe prodhonin ne vitet '90. Ne pellgun Tirane-Durres ndodhen 70% e rezerves se pergjithshme, Korce-Pogradec 10% dhe Memaliaj 4%. Nga analizat e kryera per sa me siper, rezulton se rezervat e provuara ne kete pellg qymyri jane rreth 114.96 Mtoe.

Karakteristikat e qymyrit ne vendin tone jane te kualitetit te dobet, ku permbajtja e sulfurit eshte rreth 3-5%, permbajtja e hirit eshte 40-60% dhe lageshtia arrin deri ne 60%. Qymyret tona kane nje fuqi kalorifike nga 2000 kcal/kg deri ne 3000 kcal/kg dhe ata nxirren nga nje thellesi deri ne 300 m, me nje gjeresi shtrese 0,7-1m.

Per shkak te kostos se larte te nxjerrjes dhe vetive fiziko-kimike jo te favorshme, qymyri vendas ne nje te ardhme te afert, nuk do te perdoret. Megjithate, duke pasur parasysh rezervat e kufizuara te hidrokarbureve ne bote, mundesia e perdorimit te qymyrit te importit per nevoja energjetike eshte lene e hapur. Natyrisht, perdorimi i tij do te behet duke respektuar rregullat strikte mjedisore per impiantet qe perdorin kete objekt energjetik.

9. DRUTE E ZJARRIT

Drute e zjarrit jane nje burim i rendesishem energjie, te cilet ka dhene dhe vazhdon te japin kontribut te ndjeshem ne bilancin energjetik shqiptar, ne plotesimin e nevojave per ngrohje, uje te ngrohte dhe gatim. Ne vitin 2011, rezulton qe 90% e druve te zjarrit jane konsumuar ne sektorin e banesave dhe vetem nje pjese e vogel ne sektorin e sherbimeve dhe te industrise. Krahasuar me periudhen e viteve te kaluara, vihet re qe struktura e konsumit te druve te zjarrit sipas sektoreve ka ruajtur te njejtin tipar, ate te perdorimit te tyre ne sektorin e banesave.


Konsumi i druve te zjarrit edhe ne vitin 2011 (e llogaritur) konsiderohet te jete ne nivelin 208 ktoe.

10. KONSUMI I BURIMEVE ENERGJETIKE NE INDUSTRIE NXJERESE DHE PERPUNUESE TE NAFTES

Totali i vleresuar i burimeve energjetike te konsumuara ne deget e industrise nxjerrrese dhe perpunuese ka qene ne vleren 89.86 ktoe, respektivisht: 43.8 ktoe ne industrine e naftes sidomos ne deget e industrise nxjerrrese dhe perpunuese dhe 46.9 ktoe eshte konsum ne sektorin e rafinerise.

11. KONSUMI BURIMEVE ENERGJETIKE

Konsumi burimeve energjetike ne vitin 2011, ka rezultuar ne vleren e 1913.32 ktoe (shif pasqyren e bilancit bashkengjitur). Peshen kryesore ne konsumin final e ka mbajtur nafta dhe nen produktet e saj, ne nivelin e 59.2 % te totalit te konsumit te burimeve energjetike, me pas vjen energjia elektrike me 25.4% dhe 10.9% drute e zjarrit. (Grafiku 11)




Grafiku 11: Konsumi Final Energjetik sipas burimeve [ktoe]

11. KONSUMI FINAL I BURIMEVE ENERGJETIKE SIPAS DEGEVE TE EKONOMISE

Lidhur me konsumin final te burimeve energjetike, ne grafikun1 vërejmë se konsumi, sipas sektorëve të ekonomisë, nga viti 1999 deri në vitin 2011 ka pësuar ndryshime jo të mëdha. Konsumi final i burimeve në vitin 2011 ka qenë në vlerën 1913.32 ktoe. Krahasuar me vitin 2010 kemi një rritje të konsumit total të energjisë me 1.8 %, si pasojë e zhvillimit ekonomik të vendit tonë si dhe e rritjes vjetore të fluksit të automjeteve.

Sektori i transportit mban peshën më të madhe përkundrejt totalit të konsumit të energjisë me 39.9. %, sektori i banesave 24.9 %, industria 18.5 %, sektori i shërbimeve 8.4 % dhe bujqësia e të tjerat 8.3 %.



Grafiku. 12: Konsumi final i burimeve energjetike sipas çdo sektori [ktoe] (Burimi: AKBN)

Konsumi final i energjisë elektrike sipas sektorëve të ekonomisë është paraqitur në grafikun 2. Në vitin 2011 sektori i banesave ka konsumuar 47.9 % të energjisë elektrike. Pas tij vjen sektori i shërbimeve me 22.9 %, sektori i industrisë me 18.6 %, sektori i bujqësisë me 2.1 % dhe të tjera 8.4%. Vlen të theksojmë, se gjatë vitit 2011 furnizimi i konsumatorëve në periudhat e pikut ka patur probleme vecanerisht në zonat rurale ku ndërprerjet kanë qenë problematike.


Për periudhën 2007-2011, nga analiza në mënyrë të detajuar e të dhënave të prodhimit të energjisë elektrike, vërehen ndryshime jashtëzakonisht të mëdha.

Prodhimi më i ulët vjetor gjatë kësaj periudhe është ai i vitit 2007 me 2,918 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh. Ndërsa prodhimi më i madh është ai i vitit 2010 me 7,743 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh. Sikurse vihet re diferenca ndërmjet këtyre dy prodhimeve ekstreme arrijnë në 2.7 herë. Një tregues i tillë shpreh në mënyrë sinjifikative shkallën e lartë të riskut në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik të vendit tonë, të mbështetur vetëm në HEC-e.

Po kështu, për periudhën 2007-2011 vërehet një rritje e ndjeshme e prodhimit vendas të naftës brut, duke arritur në vitin 2011 në 891 000 ton (nga rreth 320 000 ton, që ka qënë në vitin 2000), ndërkohë që përpunimi i naftës brut në rafineritë të vendit ka pësuar rënie, si në vlerë absolute, por për më tepër në vlerë relative, në krahasim me prodhimin e naftës brut në vend, duke bërë, që të rritet gjithmonë e më tepër eksporti i naftës brut.

Në grafikun 13, paraqitet konsumi final i produkteve të naftës, ndarë sipas sektorëve të ekonomisë, për periudhën 1999-2011, ku vërejmë një rritje të konsumit të naftës në sektorët e transportit, të shërbimeve dhe të industrisë.

Produktet e naftës e kanë rritur kontributin e tyre në konsumin final të energjisë nga 57.2% në vitin 1999 në 59.2 % në vitin 2011. Rritja e kontributit të tyre ka ndodhur për shkak të uljes së konsumit të druve të zjarrit, qymyrit dhe gazit natyror nga njëra anë, por edhe për shkak të rritjes së konsumit të nënprodukteve të naftës nga sektori i transportit nga ana tjetër.



Bazuar në bilancin energjetik të vitit 2011, rezulton, që sektori i transportit ka konsumuar rreth 67.7 % të produkteve të naftës, sektori i industrisë 16.3 %, sektori i bujqësisë përfshirë dhe peshkimin ka konsumuar 6.5 %, shërbimet 2.2% dhe sektori i banesave ka konsumuar 7.1 % të produkteve të naftës.


12. ANALIZA E BURIMEVE ENERGIJETIKE NE KONSUMIN FINAL SIPAS DEGEVE

12.1 Produktet e naftes

Vleresimet e bera per vitin 2011 tregojne se konsumi i produkteve hidrokarbure ka pesuar nje rritje te lehte rreth 1.3% ne vit, krahasuar me vitin 2010. Ritmi kesaj rritje ndodh si pasoje e ndikimit te i parkut te automjeteve i cili rritet me 7 % cdo vit.

Per vitin 2011, konsumi i produkteve te naftes rezulton te jete 1133.2 ktoe, ku ne kete sasi rreth 80% mbulohet nga produktet e importuara. Duke analizuar statistikat e produkteve hidrokarbure del qarte se importet jane rritur ne menyre te ndjeshme brenda 6 viteve te fundit dhe kjo parashikohet te vazhdoje edhe ne te ardhmen si pasoje e rritjes se zhvillimit ekonomik te vendit.

Duke iu referuar sektoreve ekonomik per konsumin e produkteve te naftes, transporti ze vendin kryesor me 67.7 % te totalit te konsumit final, industria me 16.3%, bujqesia me 6.5%, banesat me 7.1% sherbimet 2.2%. (figura 15).




Grafiku 15: Konsumi Final i Naftes & Nenprodukteve/ sektoreve ekonomike. Viti 2011. [%]

Krahasuar me bilancin e vitit 2010 konsumi i produkteve te naftes ne sektorin e industrise ka rritje me 27.8 ktoe si pasoje e zhvillimit qe po peson ky sektor, ne mbetet te zhvillimit ekonomik. Sektori i transportit rritet me 7.57 ktoe, si pasoje e rritjes se parkut te automjeteve per vitin 2011 karahasuar me vitin 2010. Sektori i banesave dhe i sherbimeve ka patur nje ulje te konsumit si pasoj e perdorimit te energjiise elektrike dhe druve te zjarrit. Ndersa bujqesia ka nje ulje rreth 4 ktoe si pasoje e ndikimit te rritjes se cmimit te produkteve te naftes. (Grafiku 13)

Diezeli rezultojn si karburanti kryesor ne bilancin e produkteve te naftes ne Shqiperi me rreth 63% te konsumit dhe me pas vjen benzina me 10.5%.

Analizat e detajuara te ecurise se konsumit te produkteve te ndryshme te naftes per vitin 2011 tregojne se gazi i lengshem i naftes ka patur nje ulje 9 ktoe krahasuar me vitin 2010 si pasoje e cmimit. Sidoqofte parashikimet e sektorit te energjise tregojne se LPG do te vazhdoje te ritet, pasi kjo lende energjetike eshte zevendesuesja me e shpejte e energjise elektrike. Per vitin 2011 konsumi i gazit te lengshem ka qene ne nivelin 101 ktoe. (theksojme qe te dhenat mbi konsumin e produkteve te naftes jane bazuar mbi te dhena zyrtare dhe vleresime nga AKBN-ja).



Grafiku 16: Konsumi Final i Energjise produkteve te naftes ne deget e ekonomise 1999-2011 [ktoe]

12.2 Konsumi i Energjise Elektrike sipas degeve te ekonomise

Ne vendin tone konsumi familjar ndaj konsumit te pergjithshem te faturuar edhe per vitin 2011 perben 51.4% cka tregon nje ekonomi me zhvillim industrial te kufizuar. (Ne llogaritjen e ketij treguesi jemi bazuar ne pasqyren e struktures se shitjes te raportit vjetor te CEZ Shperndarje e cila permban edhe faturimet per demin ekonomik prej 278 GWh si dhe energjine e pafaturuar 156 GWh per te cilin kompania nuk jep te dhena analitike mbi sasite e faturuara ne secilin grup konsumatoresh).

Duke qene keshtu, ritmet e larta te zhvillimit ekonomik te vendit do te ndikojne edhe ne rritjen e ritmeve te kerkese per energji.

Nje peshe te rendesishme ne konsumin e energjise elektrike zene edhe konsumatoret buxhetor dhe jo buxhetore, te keta te fundit bejne pjese kryesisht ujesjellesit dhe hidrovolet te cilet jane edhe debitoret me te medhej ndaj OSSH-se.

Konsumatorët familjare (me çmimet perkatese 7.70 lek/kWh dhe 13.5 lek/kWh) perbejne peshen kryesore ne te ardhurat e OSSH-se.

Struktura e konsumit te energjise elektrike ndikon drejtpersedrejt edhe ne profilin e ngarkeses ose te konsumit te energjise elektrike. Me Janar 2011, ku eshte shenuar edhe konsumi maksimal per vitin 2011 prej 25.996 milion kWh/dite si dhe profili i konsumit ne 10 Prill 2011 qe i perket konsumit minimal per vitin 2011 prej 17.705 Milion kWh/dite.

Perdorimi i energjise elektrike per ngrohje perben nje dukuri tjeter problematike te konsumit te energjise elektrike ne vendin tone. Cdo ndryshim i temperatures se mjedisit reflektohet menjehere ne konsumin ditor te energjise elektrike, pikerisht te efektit nga perdorimi ose mosperdorimi i ngrohjes elektrike te baneses.

Sikuese shihet ndryshe nga viti 2010 ku per here te pare qe mbas vitit 1998, ne bilancin e pergjithshem import-eksport, eksportet tejkaluan importet dhe vendi yne rezultoi si vend eksportues neto i energjise elektrike, viti 2011 perseri sjell kthimin e vendit ne importues neto.

Ecuria e treguesve te prodhimit vendas dhe importit te energjise elektrike gjate viteve 2002-2011




Figura 17 Konsumi i pergjithshem ne vite energjise elektrike

Struktura e konsumit te energjise elektrike shpreh ne menyre te sintetizuar edhe shkallen e zhvillimit ekonomiko-industrial te nje vendi. Ne vendin tone konsumi familjar ndaj konsumit te pergjithshem te faturuar edhe per vitin 2011 perben 47.9% cka tregon nje ekonomi me zhvillim industrial te kufizuar. Duke qene keshtu, ritmet e larta te zhvillimit ekonomik te vendit do te ndikojne edhe ne rritjen e ritmeve te kerkese per energji.

Sic vihet re nga grafiku, peshen me te madhe ne konsumin e energjise elektrike per vitin 2011, e mban sektori banesave me 47.9%, e me pas vijne sherbimet me 22.9%, industria 18.6 %, te tjera 8.4% dhe bujqesia me 2.1%.

Ne sektorin shtepiak eshte ruajtur e njejta strukture e konsumit te energjise elektrike, respektivisht; 29% e energjise elektrike te konsumuar eshte perdorur per ngrohje, rreth 22%, konsumohet per uje te ngrohje, rreth 25% per gatim etj.




Figura 18: Konsumi final i energjise elektrike ne deget e ekonomise. Viti 2011 [%]

Ne sektorin e industrise peshen me te madhe ne konsumin e energjise elektrike e mban Industria Ushqimore e Pijeve & Duhanit me 20%, me pas vijne deget e industrise materialeve te ndertimit me 18%, e hekurit me 15%, etj.

Ne Sektorin e Sherbimeve vihet re e njejta strukture e konsumit te energjise elektrike, konkretisht: per gatim, kondicionim (ngrohje dhe freskim), ndricim, paisjet elektroshtepiake, etj. Sektori i Sherbimeve ze rreth 10% te totalit te konsumit final te burimeve energjetike dhe ne menyre specifike 23.6% te konsumit te energjise elektrike.

13. DRUTE E ZJARRIT DHE QYMYRI

Drute e zjarrit dhe qymyri nuk paraqesin ndryshime strukture te perdorimit te tyre ne deget e ekonomise, megjithate veme ne dukje qe mungojne informacionet e sakta per furnizimin dhe konsumin me keto burime energjie.

14. KONSUMI I BURIMEVE TE RINOVUESHME

Nisur nga pozicioni gjeografik, me nje klimë tipike mesdhetare, Shqipëria zotëron burime të konsiderueshme të energjive të rinovueshme. Këto burime mund të shfrytëzohen jo vetëm për zvogëlimin e kontributit të energjisë elektrike nga burimet konvencionale, por dhe për përfitimin e energjive të tjera të pastra.

Hidroenergja është përfitimi më i madh nga burimet e rinovueshme në vendin tonë. Shqipëria renditet në Europë si një vend me pasuri ujore të konsiderueshme, me një shtrirje hidrografike të shpërndarë, pothuaj në të gjithë territorin.

Shqipëria, me sipërfaqen e saj prej 28 748 km², ka një shpërndarje hidrografike me një sipërfaqe ujëmbledhëse prej rreth 44,000 km² ose 57% më shumë se territori shtetëror. Nga pikpamja topografike, duke qenë një vend me reliev relativisht të thyer, vendi ynë ka një rezervë hidroenergjitike të madhe.

Nëpërmjet një politike koncensionare konkurruese e transparente dhe të mbështetur në një kuader të plotë ligjor dhe nënligjor, u bë e mundur që të nënshkruhen dhe miratohen nga Qeveria, 112 kontrata koncensionare, për ndërtimin e HEC-eve me fuqi të vogël, të mesme dhe të madhe, me investitorë vendas dhe të huaj, prej të cilëve pritet, që të futet në shfrytëzim një potencial gjenerues hidroelektrik prej rreth 1400 MW, që parashikohet të prodhojë një sasi energjie elektrike nga burime të rinovueshme prej 4 miliarde kWh në vit.

Energjia Diellore

Territori i Shqipërisë është i vendosur në pjesën perëndimore të Ballkanit dhe ka një potencial të lartë për shfrytëzimin e **energjisë diellore**. Numëri i ditëve me diell në vendin tonë luhet nga 240 – 260 ditë me një maksimum prej 280 ditë, megjithatë kontributi i kësaj energjie, përkundërt totalit të burimeve energjetike, është jo më shumë se 0.1%. Kryesisht energjia diellore shfrytëzohet për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe një pjesë fare e vogël e kësaj energjie shfrytëzohet me panele fotovoltaike. Bazuar në të dhënat e vitit 2011, penetrimi i paneleve për ujë të ngrohtë është 23.5 m²/1000 banor

Për këtë arsye, në strategjinë kombëtare të energjisë, shtimi i përdorimit të paneleve diellore është prioritet i qeverisë dhe në këtë kuadër po punohet me një projekt në bashkëpunim me UNDP.

Energjia e erës

Shfrytëzimi i **energjisë së erës** në vendin tonë akoma nuk ka filluar, por ka një shprehje shumë të madhe interesimi nga investitorë të huaj, për shfrytëzimin e këtij burimi. Në këtë kuadër, janë në studim disa rajone të vendit tonë nga disa kompani të huaja. Deri në fund të vitit 2011, nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës si dhe nga ERE janë licensuar 15 kompani, për të ndërtuar parqe eolike me një fuqi të instaluar prej rreth 1 600 MW, të cilat shtrihen kryesisht në zonën bregdetare të vendit, duke filluar nga qarku i Lezhës në veri e deri në rajonin e Sarandës në jug.

Biomasa

në vendin tonë vlerësohet si burim energjie dhe është ngushtësisht e lidhur me drutë e zjarrit. Në vitin 2011, rezulton që 93% e druve të zjarrit të përdorura, janë konsumuar për ngrohje dhe gatim dhe vetëm 7% është përdorur në shërbime të tjera. Biomasa kontribuon nëpërmjet druve të zjarrit në bilancin energjetik të vendit me 7.76 %. Në mbështetje të shfrytëzimit të biomasës në vitin 2008 është dhënë licenca për ndërtim, instalim dhe prodhim të energjisë elektrike, nga një TEC-i me fuqi të instaluar 140 MW

	Year 2011	TOTAL	Solid fuels	Natural Gas	Crude, NGL and Feedstock	Biomass (Fuelwood)	Hydro & Electricity	Solar Energy	Derived Heat
Primary production		1494.20	1.6	15.0	894.53	208	357.59	11.70	5.8
Recovered products		0.00			0.0				
Imports (Pet Prod+ Electricity)		1455.54	69.8		1105.20		280.53		
Stock change		0.00			0.00				
Exports		787.95			767.99		19.96		
Bunkers		0.00							
Gross inland consumption		2161.79	71.41	15.0	1231.74	208.00	618.16	11.70	5.80
Transformation input		654.31			296.72		357.59		
Classic thermal Power Stations		12.97			10.67		2.3		
Public Hydro power stations		352.09					352.09		
Autoprod. thermal power stations		0.40			0.00		0.4		
Nuclear power stations		0.00							
Patent fuel and briquetting plants		0.00							
Coke-oven plants		0.00							
Blast-furnace plants		0.00							
Gas works		0.00							
Refineries		296.72			296.72				
District heating plants		0.00							
Transformation output		663.20	0	0	286.72		354.89		3.3
Classic thermal Power Stations		5.10					5.10		
Public Hydro power stations		349.79					349.79		
Autoprod. thermal power stations		0.00							
Nuclear power stations		0.00							
Patent fuel and briquetting plants		0.00							
Coke-oven plants		0.00							
Blast-furnace plants		0.00							
Gas works		0.00							
Refineries		290.02			286.72				3.3
District heating plants		0.00	0						
Exchanges and transfers, returns		0.00							
Interproduct transfers		0.00							
Products transferred		0.00							
Returns from petrochem. industry		0.00							
Transformation Losses		12.70	0	0	10.00		2.70		
Consumption of the energy branch		93.11		15.0	39.00		39.11		0
Production and distribution of electricity		0.41					0.41		
Pumped storage stations		0.00							
District heating plants		0.00							
Extraction and aggro. of solid fuels		0.00							
Coke-oven and gas works plants		0.00							
Oil and Nat. Gas extraction plants		43.80		9.0	9.00		25.80		
Oil & Gas pipelines		0.00							
Oil refineries		46.90		4.0	30		12.9		
Nuclear fuel fabrication plants		0.00							
Distribution losses (humbje jo tekn. ne shpernd)		89.86					89.86		0.00
Available for final consumption		1952.15	71.41	0.0	1172.07	208.00	486.48	11.70	2.50
Final non-energy consumption		38.83			38.83				
Chemical industry		4.82			4.82				
Other sectors		34.01			34.01				
Final energy consumption		1913.32	71.4	0.0	1133.2	208.0	486.48	11.7	2.5
Industry		355.77	68.0		184.46	10	90.52	0.29	2.5
Iron & steel industry		25.65			14.03		11.62		
Non-ferrous metal industry		4.47			0.05		4.42		
Chemical industry		17.10			9.90		7.20		
Glass, pottery & building mat. industry		194.83	68		112.71		14.12		
Ore-extraction industry		5.56			0.49		5.07		
Food, drink & tobacco industry		45.88			25.38		17.71	0.29	2.5
Textile, leather & clothing industry		12.50			0.93		11.57		
Paper and printing		8.26			1.00		7.26		
Engineering & other metal industry		7.80			3.50		4.31		
Other industries		35.72		2.00	16.49	10	7.23		
Transport		767.00			767.00				
Railways		3.00			3.00				
Road transport		723.95			723.95				
Air transport		20.05			20.05				
Inland navigation		20.00			20.00				
Households, commerce, pub. auth., etc.		640.12	3.4		104.50	176.0	344.81	11.41	
Households		479.49	0.9		80.00	160	233.21	5.38	
Agriculture		75.67			53.29	12	10.38		
Fisheries		25.00			25.00				
Other		40.77			0.00		40.77		
Statistical difference					250.00			0	0